



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE \* MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA \* SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, pika 3.1, shkronja h të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dispozitave të nenit 19, par.1, pika ë dhe nenit 40, shkronja i të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.3.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 27.7.2007, merr

## **V E N D I M**

### **PËR CAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURËN E DHËNIES SË QOSHQEVE NË SHFRYTËZIM**

#### **Neni 1**

Miratohet Vendimi për caktimin e kriterëve dhe procedurën e dhënies së qoshqeve në shfrytëzim.

#### **Neni 2**

Me këtë vendim përcaktohen kriteret dhe procedura e dhënies së qoshqeve në shfrytëzim, në të cilat Komuna e ka të drejtën e pronësisë.

#### **Neni 3**

Qoshqet e vendosura në lokacionet e planifikuara me Planin për vendosjen e qoshqeve, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-35-435, të dt. 31.8.2006 dhe të atij nr. 01-353-200, të dt. 17.5.2007, do të jepen në shfrytëzim në bazë të kriterëve dhe procedurave të parapara me këtë vendim.

#### **Neni 4**

Qoshqet e vendosura në lokacionet e planifikuara me planet nga neni 3 i këtij vendimi, do të jepen në shfrytëzim dhe atë:

18 prej tyre, në bazë të procedurave konkurruese (tenderit publik) dhe 32 prej tyre, në bazë të dhënies së drejtpërdrejtë.

Nga numri i qoshqeve të parapara për dhënie në shfrytëzim sipas procedurës nga par. 1, pika 2 e këtij neni:

14 prej tyre i jepen në shfrytëzim kontraktuesit të zgjedhur nga Komuna për punimin e qoshqeve;

1 prej tyre, në bazë të marrëveshjes për kompensimin e përkohshëm të pronës së ekspropriuar me Vendimin e Drejtoratit të Financa dhe Pronës nr. 010-465-17782, të dt. 21.9.2006,

17 prej tyre parashihen për 34 familje skamnore dhe raste të tjera sociale.

Dhënia e qoshqeve në shfrytëzim, nga par. 1 pika 2 e këtij neni, do të bëhet në bazë të procedurave të parapara me Ligjin mbi prokurimin publik dhe Ligjin mbi procedurën e dhënies së koncesioneve.

Dhënia e qoshqeve në shfrytëzim, nga par.1, pika 2 e këtij neni, do të bëhet sipas kriterëve dhe procedurave të parapara me këtë vendim.

## **Neni 5**

Dhënia e qoshqeve sipas procedurave konkurruese, do të bëhet me shpalljen e ofertave publike në mediat e shkruara.

Në ofertat e publikuara do të përcaktohen kriteret parësore për dhënien e qoshqeve në shfrytëzim, të vendosura në lokacionet e planifikuara sipas planeve nga neni 3 i këtij vendimi.

Kritere parësore në kuptim të paragrafit 2 të këtij neni, konsiderohen: përshkrimi i lokacioneve të objekteve të vendosura, që jepen në shfrytëzim sipas kësaj procedure;

sipërfaqja e objektit- qoshkut;

afati i dhënies në shfrytëzim ;

numri i qoshqeve për të cilat mund të ofertohej dhe çmimi fillestar mujor për një m<sup>2</sup> i kompensimit të ofruar.

## **Neni 6**

Afati për dhënien e qoshqeve në shfrytëzim do të jetë 3 vjet.

Ofertat për dhënien e qoshqeve sipas procedurës konkurruese, mund të pranohen më së shumti për 3 qoshqe të një ofruesi.

## **Neni 7**

Çmimi fillestar, në kuptim të nenit 5, par. 3, pika 5, do të jetë:

40 euro për një m<sup>2</sup>, për qoshqet e vendosura në zonën I të qytetit;

35 euro për një m<sup>2</sup>, për zonën II të qytetit

25 euro për një m<sup>2</sup>, për zonën III të qytetit dhe

20 euro për zonat tjera.

## **Neni 8**

Marrëdhëniet tjera obliguese për mënyrën dhe kushtet tjera të shfrytëzimit të qoshqeve me ofertuesin e zgjedhur sipas kësaj procedure, do të rregullohen me kontratë të veçantë në mes Komunës dhe ofertuesit të zgjedhur.

## **Neni 9**

Qoshqet jepen në shfrytëzim në bazë të dhënies së drejtpërdrejtë, sipas procedurës nga neni 4, par. 2. pika 1, do të bëhet sipas kushteve dhe procedurave të parapara me kontratën e lidhur në mes përfituesit të zgjedhur për punimin e qoshqeve dhe Komunës. Dhënia e qoshkut në shfrytëzim, nga neni 4, par 2, pika 2, do të bëhet pa kompensim dhe sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e dt. 11.4.2007.

Dhënia e qoshqeve në shfrytëzim, sipas procedurës dhe subjekteve nga neni 4, par. 2, pika 3 e këtij vendimi, do të bëhet nga përzgjedhja e përfituesve nga evidencat e përpiluara nga Drejtorati i Shëndetësisë dhe i Mirëqenies Sociale i Komunës së Prishtinës.

Evidenca, nga par. 3 i këtij neni, pas shqyrtimit nga Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës, do të miratohet nga kryeshefi i Ekzekutivit të Komunës së Prishtinës.

### **Neni 10**

Dhënia e qoshqeve në shfrytëzim personave të cekur në par.3 , neni 9 të këtij vendimi, do të bëhet me kompensim.

Kompensimi, nga par. 1 i këtij neni, do të jetë në lartësinë:

Për qoshqet e dhëna në shfrytëzim, të vendosura në zonën e parë (I) të qytetit, shuma mujore prej 35 euro për një m<sup>2</sup>;

Për qoshqet e dhëna në shfrytëzim, të vendosura në zonën e dytë (II) të qytetit, shuma mujore prej 25 euro për një m<sup>2</sup> dhe

Për qoshqet e dhëna në shfrytëzim, të vendosura në zonën e tretë (III) të qytetit, shuma prej 20 euro për një m<sup>2</sup> dhe 15 euro për zonat tjera.

Çmimi i kompensimit të përcaktuar me këtë dispozitë, do të rishqyrtohet dhe mund të ndryshojë me kontratën për vazhdimin e të drejtës për shfrytëzimin e qoshkut, për çdo dy vjet.

Ndryshimi i lartësisë së kompensimit të caktuar me këtë dispozitë, do të bëhet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

### **Neni 11**

Dhënia e qoshqeve në shfrytëzim, sipas dhënies së drejtpërdrejtë përfituesve nga par. 1 i nenit 9, do të bëhet në bazë kontratës.

Kohëzgjatja për dhënie në shfrytëzim sipas kësaj procedure, do të jetë dy vjet me mundësi vazhdimi.

Kontrata, nga par. 1 i këtij neni, do të nënshkruhet nga përfituesi i së drejtës për shfrytëzimin e qoshkut dhe kryeshefi i Ekzekutivit të Komunës së Prishtinës.

Me kontratën për shfrytëzimin e qoshkut, do të rregullohen marrëdhëniet e të dy palëve kontraktuese nga par. 2 i këtij neni, konform rregullativës ligjore nga lëmi i obligacioneve.

### **Neni 12**

Vazhdimi i të drejtës për dhënien e qoshkut në shfrytëzimin do të bëhet nga kryeshefi i Ekzekutivit.

Kontrata për dhënien e qoshkut në shfrytëzim mund të shkëputet edhe para skadimit të afatit të përcaktuar.

Rastet kur kontrata mund të shkëputet para afatit të përcaktuar, do të përshkruhet në kontratën për dhënien e qoshkut në shfrytëzim.

Si kusht i domosdoshëm për shkëputje të parakohshme të kontratës, do të jetë realizimi i planeve urbanistike dhe programeve tjera komunale, të cilat bien ndesh me planin për vendosjen e qoshqeve, si dhe kushtet tjera që përcakton Komuna si palë kontraktuese.

Kushtet e përshkuara me këtë dispozitë për shkëputje të parakohëshme, do të zbatohen edhe për përfituesit e zgjedhur për dhënien e qoshqeve në bazë të ofertave publike.

### **Neni 13**

Llojin e veprimtarisë që lejohet të ushtrohet në qoshqet e dhëna në shfrytëzim sipas këtij Vendimit, do t'i përcaktojë Drejtorati i Ekonomisë i Komunës së Prishtinës me leje pune.

#### **Neni 14**

Kriteret parësore për dhënien e qoshqeve në shfrytëzim, në bazë të dhënies së drejtpërdrejtë personave të përzgjedhur nga neni 9, par.3 i këtij vendimi, janë :

- të jetë banor i komunës së Prishtinës,  
gjendja ekonomiko-sociale e ofertuesit,  
gjendja shëndetësore e ofertuesit dhe e anëtarëve të familjes së tij,  
numri i anëtarëve të familjes së ngushtë,

statusi i familjes së dëshmorit dhe  
statusi i familjes së invalidit.

#### **Neni 15**

Vlerësimi i kriterëve parësore, nga neni 14 i këtij Vendimi, do të jetë:

- gjendja sociale \_\_\_\_\_ 60 pikë,
  - statusi i anëtarit të familjes së dëshmorit \_\_\_\_\_ 6 pikë shtesë,
- gjendja shëndetësore e ofertuesit (për rastet sociale):
- invalid, si pjesëmarrës i luftës \_\_\_\_\_ 5 pikë,
  - invalid civil i luftës \_\_\_\_\_ 4 pikë,
  - invalid i punës \_\_\_\_\_ 3 pikë,

Për secilin anëtarë të familjes së ngushtë do të llogariten nga 2 pikë.

Përparësitë për dhënien e qoshkut në shfrytëzim, sipas dhënies së drejtpërdrejtë personave nga neni 9 al. 3 të këtij vendimi, gjatë hartimit të evidencës nga neni 9, par. 4 i këtij vendimi, do të bazohet në kriteret e përshkruara në këtë dispozitë.

#### **Neni 16**

Shqyrtimi dhe zgjidhja e ankesave dhe parashtresave eventuale për listën e shpallur, do të bëhet në përputhje me rregullativën ligjore nga lëmi i procedurës administrative dhe ai për vetëqeverisje lokale.

#### **Neni 17**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01.Nr. 353-335, më.24.07.2007**

**KRYETARI I KUVENDIT**  
**Ismet Beqiri**